


REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	05
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-1590/15
Data Datum Date	18.06.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	17.06.2015
REFERENC-Ë:	DPK-DPKPP 03-03/843/15
PËR/ZA/TO:	z. Besim MULAJ U.D. Menaxher i Prokurimit në Komunën e Pejës
CC:	z. Gazmend MUHAXHERI Kryetar i Komunës së Pejës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENDI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Shëtitorja e Lumëbardhit "

I nderuari z. Mulaj ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Shëtitorja e Lumëbardhit " me numër prokurimi 18019-15-016-511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Shëtitorja e Lumëbardhit " me numër prokurimi 18019-15-016-511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsy etimi

Komuna e Pejës si Autoritet kontraktues, përmes Zyrës së Prokurimit ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull " Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Shëtitorja e Lumëbardhit " me numër prokurimi 18019-15-016-511, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.13.03.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit Punë me vlerë të madhe të kontratës.

Autoriteti kontraktues me dt.23.03.2015, përmes Zyrës së Kryetarit ka paraqitur kërkesë zyrtare në Agjencinë kundër Korrupsionit, përmes së cilës ka kërkuar që përfaqësuesit e AKK-së të marrin pjesë në vëzhgimin lidhur me vlerësimin e tenderit me titull " ***Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Shëtitorja e Lumëbardhit " me numër prokurimi 18019-15-016-511.*** Më datë 25.03.2015 Agjencia Kundër Korrupsionit ka paraqitur Njoftimin zyrtar pranë Autoritetit Kontraktues me të cilin e ka njoftuar të njëjtin se Zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit do të jenë prezent në procedurën rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve.

Zyrtarët Përgjegjës të AKK-së kanë marr pjesë në vëzhgimin e punës së Komisionit vlerësues rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve dhe pasi kanë shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet përkatëse në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit kanë konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej **68** Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar **19** prej tyre.

Komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar të gjitha ofertat e Operatorëve Ekonomik konkurrues, ka konstatuar dhe ardhur në përfundimet si në vijim: Sipas Komisionit vlerësues prej 19 ofertave të pranura për këtë tender vetëm 4 prej tyre i plotësojnë kriteret minimale të Dosjes së Tenderit dhe kualifikohen në vlerësimin e mëtutjeshëm. Lidhur me këtë Komisioni vlerësues i ka rekomanduar Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që Operatori ekonomik i përgjegjshëm i cili ka ofruar çmimin më të ulët të shpallet fitues dhe me të lidhet kontrata.

Zyrtarët Përgjegjës të AKK-së kanë marr pjesë në vëzhgimin e punës së Komisionit vlerësues rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve për aktivitetin e prokurimit " ***Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Shëtitorja e Lumëbardhit " me numër prokurimi 18019-15-016-511.***

Gjatë kohës së vlerësimit dhe pas përfundimit të monitorimit është kërkuar që të dorëzohet dokumentacioni i kompletuar dhe është njoftuar Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit që duhet ta dorëzoj dokumentacionin e kërkuar në mënyrë që Agjencia ta trajtoj atë, para se Zyra e Prokurimit ta shpallë fituesin e këtij tenderi. Përkundër kësaj Zyrtari Kryesor i Prokurimit nuk ka vepruar sipas kërkesës së Agjencisë.

Zyra e prokurimit ka vepruar në këtë mënyrë pa e dorëzuar paraprakisht dokumentacionin e kompletuar për lëndën në fjalë edhe pse Agjencia gjatë kohës se monitorimit i ka bërë me dije se duhet ta sjellë dokumentacionin e nevojshëm për punë, këtë i'a kemi përsëritur edhe

përmes telefonit Zyrtarit Përgjegjës. Zyrtari në fjalë ka premtuar se do ta sjellë dokumentacionin e kompletuar brenda afatit, përkundër kësaj Agjencia ka pritur më tepër se 10 ditë dokumentacionin e kërkuar por zyra e prokurimit ka neglizhuar kërkesën dhe duke vepruar në mënyrë të njëanshme ka shpallur fituesin pa e përfillur kërkesën tonë dhe pa pritur Opinionin e Agjencisë kundër korrupsionit. Me datë 19.05.2015 Autoriteti Kontraktues, përmes faqes elektronike të KRPP-së ka bërë Njoftimin për dhënie të kontratës me të cilin e ka shpallur fitues të këtij tenderi Operatorin ekonomik të përgjegjshëm sipas Komisionit vlerësues dhe i cili kishte ofruar çmimin më të ulët.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes tërë dokumentacionin përkatës në dispozicion në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar të gjeturat si në vijim:

Në Dosjen e përgatitur për këtë tender tek rubrika **9.1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale kërkesat nr.4 është kërkuar një projekt në vlerë mbi 3.000.000,00 € të realizuar gjatë tri viteve të fundit për punë ndërtimore**, kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik. Sipas këtij Ligji për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë vlera minimale referenca në lidhje me punët ndërtimore në 3 vitet e fundit përmes një liste që specifikon secilin nga projektet punuese të Operatorëve ekonomik dhe aktivitetëve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellë me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktivitetëve të ndërtimit. Por nuk është e lejuar që të kërkojë një projekt i vetëm duke e caktuar edhe vlerën e projektit të realizuar. Nëse Autoriteti kontraktues ka për synim që ta vërtetojë qarkullimin minimal financiar të realizuar përmes kontratave atëherë duhet që ta kërkojë për të gjitha kontratat e punëve të realizuara në tri vitet e fundit e jo të kërkojë një kontratë me referencë e vetme në këtë vlerë.

Lidhur me këtë Agjencia ka vërejtur se 8 prej Operatorëve ekonomik konkurrues janë eliminuar pasi që nuk kanë dëshmuar se kanë realizuar një projekt të vetëm në vlerë prej 3.000.000,00 €, e ka pasur Operatorë në mesin e tyre që kanë ofruar disa kontrata me referenca për punët e realizuara në tri vitet e fundit që kalojnë vlerën mbi 7.000.000,00 €, por që nuk kanë pasur ndonjë projekt të vetëm në vlerën siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka ekzaminuar dhe krahasuar me kujdes ofertën e Operatorit Ekonomik i cili është shpallur fitues i këtij tenderi nga Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues, ka vërejtur se kontrata dhe referenca për punë ndërtimore të realizuara në vlerë prej 3.122.760,00 € siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit është e lidhur në mes Operatorit ekonomik fitues dhe një Operatori tjetër ekonomik privat. Lidhur me këtë Komisioni vlerësues dhe Zyrtari i Prokurimit nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në mënyrë që ti vërtetojnë transaksionet në mes të këtyre Operatorëve ekonomik për ta vërtetuar realizimin e një kontrate të tillë, ani pse Zyrtari Përgjegjës i i AKK-së gjatë vlerësimit të tenderit i 'u ka rekomanduar Komisionit vlerësues dhe Zyrtarit të Prokurimit se nuk mund të pranohet kontratat dhe referencat në mes Operatorëve ekonomik Privat pa u vërtetuar transaksionet në mes tyre. Lidhur me këtë Agjencia kundër Korrupsionit me dt.27.05.2015 ka paraqitur kërkesë zyrtare në Administratën Tatimore të Kosovës ku ka kërkuar që

t'i vërtetojë Transaksionet e bëra në ndërmjet këtyre Operatorëve ekonomik, inspektimin e llogarive bankare, Inspektimin e librave shitëse dhe blerëse dhe gjendjen e përgjithshme të këtyre dy Operatorëve ekonomik për kontratën dhe referencën në vlerë prej 3.122.760,00 € të cilën e ka prezantuar Operatori ekonomik i cili është shpallë si fitues i këtij tenderi.

Me datë 12.06.2015 Agjencia Kundër Korrupsionit ka pranuar Informacionin zyrtar mbi inspektimin në terren nga Administrata Tatimore e Kosovës për transaksionet lidhur me aktivitetet ekonomike në mes këtyre Operatorëve ekonomik ku konstatohet shumë qartë ekzistojnë transaksione në mes këtyre Operatorëve ekonomik, mirëpo në Raportet zyrtare të Inspektorit Tatimor i cili ka dal për vizitë në terren, i njëjti pasi ka analizuar librat e shitjes dhe blerjes, faturat tatimore dhe pasi ka inspektuar llogaritë bankare ndërmjet Operatorëve ekonomik ka konstatuar se Operatori ekonomik fitues i këtij tenderi nuk ka bërë ndërtimin e objektit afaristo-banesor me etazhitet B+P+6NK me sipërfaqe bruto prej 9820.0 m² ashtu siç e ka prezantuar kontratën dhe referencën, por vetëm ka bërë furnizimin me material ndërtimor me Operatorin ekonomik i cili i ka dhënë referencë për ndërtim, për më tepër nga transaksionet që janë bërë në mes këtyre OE-ve nuk figuron shuma e prezantuar në kontratë por është shumë herë më e ulët sesa vlera e prezantuar në kontratë. Gjithashtu ndërtimin e këtij Objekti e ka bërë një Operator tjetër Ekonomik me ç 'rast Operatori ekonomik i cili është shpallur fitues i këtij tenderi e ka mashtruar Autoritetin Kontraktues duke prezantuar një kontratë dhe referencë e cila nuk ka të bëjë me punë ndërtimore ashtu siç kishte kërkuar Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe si i tillë Operatori ekonomik i cili është shpallur fitues i tenderit është i papërgjegjshëm, pasi që nuk e plotëson kërkesën 9.1. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale kërkesat nr.4 ku është kërkuar një projekt në vlerë mbi 3.000.000,00 € të realizuar gjatë tri viteve të fundit për punë ndërtimore.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka konstatuar edhe disa shkelje tjera si në vijim: në raportin përfundimtar të vlerësimit të tenderëve, faqe 10 Operatori ekonomik i renditur me nr.1 është shpallur i përgjegjshëm, ani pse Komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertës së këtij Operatori ekonomik kishte konstatuar se nuk i plotëson disa kërkesa të dosjes së tenderit dhe si i tillë do të duhej të shpallej si i papërgjegjshëm. Komisioni vlerësues pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të gjitha ofertave kishte konstatuar se ka 4 Operator ekonomik të cilët kanë dorëzuar oferta të përgjegjshme, ndërsa në raportin përfundimtar të vlerësimit i cili është nënshkruar nga anëtarët e komisionit vlerësues dhe Menaxheri i Prokurimit figurojnë të jenë 5 Operator ekonomik si të përgjegjshëm.

Gjithashtu në rubrikën 9.1. Kapaciteti teknik ose profesional tek pjesa shënim për pikën 1 vërejtje, ku është kërkuar '' Nëse tenderi dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik atëherë lideri kryesor duhet ta përmbush minimum 60 % të nën kriterit 9.1. paragrafi 1 për projekte të ngjashme '' kërkesë kjo për të cilën gjithashtu konsiderojmë se bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, Nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i

Tenderëve dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale, nenin 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit kërkon anulimin e Njoftimit për dhënie të kontratës dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të paraqes kërkesën pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit për futjen në listën e zezë për Operatorin Ekonomik të cilit i është dhënë kontrata.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

ves * Oa